

Monitorimi i Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

RAPORT VLERËSIMI

Nr. 2

Tetor 2025

Ky Raport Vlerësimi Nr. 2, për Eficiencën e Gjykatës dhe Cilësinë e Drejtësisë, është hartuar në kuadër të projektit “Konsolidimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm – një Rishikim i Ndikimit mbi Eficiencën e Gjyqësorit dhe Cilësinë e Drejtësisë” i zbatuar nga Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), me mbështetjen e financimit të MATRA, program i Mbretërisë së Hollandës, nëpërmjet përfaqësimit të saj në Shqipëri.

Projekti synon të përmirësojë eficiencën e performancës dhe standarteve të cilësisë së drejtësisë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë pranë saj pas shkrirjes së gjashtë gjykatave të apelit në një të vetme, në respektim të legjislacionit të miratuar për këtë qëllim.

Foto krediti (kopertina dhe brenda): ©

© ISPL, 2025

Riprodhimi është i autorizuar me kusht që të njihet e drejta e autorit.

ISPL nuk është përgjegjës për përdorimin që mund t’i bëhet informacionit të mëposhtëm.

Tabela e Përmbajtjes

Tabela e Akronimeve.....	5
I. Hyrje.....	6
II. Eficenca në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	6
II.1 Kohëzgjatja e procedurave në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	6
II.1.1 Aspekte të kohëzgjatjes së procedurave.....	7
II.1.2 Aplikimi i dënimeve alternative.....	7
II.1.3 Adoptimi i një numri unik të çështjes në sistemin e prokurorisë dhe gjykatave..	8
II.1.4 Konkluzione lidhur me masat për shmangien e vonesave në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	8
II.2 Adresimi i vonesave në procedura.....	9
II.2.1 Masat e marra për shmangien e vonesave në procedura.....	9
II.2.2 Administrimi i prokurorisë.....	10
II.2.3 Konkluzione për trajtimin e vonesave në procedura.....	10
II.3 Kategorizimi i çështjeve.....	11
II.3.1 Kategorizimi aktual i çështjeve në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	11
II.3.2 Mungesa e një metodologjie të qartë lidhur me kategorizimin e çështjeve sipas kompleksitetit të tyre.....	11
II.3.3 Konkluzione për kategorizimin e çështjeve.....	12
II.4 Ndikimi i hartës së re gjyqësore në efencën e punës së PA.....	12
II.4.1 Numri aktual i prokurorëve pranë Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	12
II.4.2 Ngarkesa e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	13
II.4.3 Konkluzione lidhur me ndikimin e hartës së re gjyqësore në efencën e Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	14
II.5 Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.....	14
II.5.1 Sfidat e përdorimit të një sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	14
II.5.2 Zhvillimet e fundit lidhur me menaxhimin elektronik të të dënave në prokurori.....	15
II.5.3 Konkluzione për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Prokurorinë e Apelit.....	16
III. Cilësia në punën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	16
III.1 Vlerësimi i prokurorëve nga KLP.....	16
III.1.1 Aktualiteti i vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve nga KLP.....	16
III.1.2 Ndryshimi i rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve....	17
III.1.3 Konkluzione lidhur me vlerësimin e prokurorëve nga KLP.....	18
III. 2 Respektimi i parimit të procesit të rregullt ligjor (due process) nga Prokuroria e Apelit.....	18
III.2.1 Standardet e evidentuara në nivel kombëtar për të siguruar procesin e rregullt ligjor në përfaqësimin e akuzës nga Prokuroria e Apelit.....	18

III.2.2 Standarde të tjera ndërkombëtare për të siguruar procesin e rregullt ligjor në përfaqësimin e akuzës nga Prokuroria e Apelit	21
III.2.3 Konkluzione lidhur me standardet e veprimeve të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	25
III.3 Pranueshmëria e vendimeve/kërkesave të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	26
III.3.1 Pranueshmëria e vendimeve/kërkesave nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	26
III.3.2 Pranueshmëria e vendimeve/kërkesave nga Gjykata e Lartë.....	28
III.3.3 Konkluzione lidhur me pranueshmërinë e vendimeve/kërkesave të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	28
III.4 Zhvillimi profesional i prokurorëve	28
III.4.1 Trajnimet vazhduese dhe sfidat e zhvillimit profesional shumëdimensional të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit	28
III.4.2 Trajnimet për punonjësit e administratës pranë Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	29
III.4.3 Konkluzione lidhur me zhvillimin profesional të prokurorëve dhe administratës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	30
IV. Konkluzione Përfundimtare dhe Rekomandime	30
Burimet	32

Tabela e Akromimeve

BE-	Bashkimi European
GJA-	Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
GJEDNJ-	Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut
GJED-	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European
GJL-	Gjykata e Lartë
ILD-	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KE-	Komisioni European
KEDNJ-	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
KLP-	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KPrP-	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
PA-	Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
PP-	Prokuroria e Përgjithshme
RSH-	Republika e Shqipërisë
SND-	Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë
UNOPS-	Zyra e OKB për Shërbime të Projekteve

I. Hyrje

Ky Raport i Dytë i Monitorimit të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm paraqitet në vijim të Raportit të Parë mbi të njëjtin monitorim, të përfunduar në mars 2025. Hartimi i këtij raporti është i rëndësishëm për shkak të nevojës për të rivlerësuar impaktin e hartës së re gjyqësore gjatë gjashtëmujorit të fundit (mars 2025-shtator 2025), duke ngritur pyetjen thelbësore nëse kjo prokurori ka vijuar të rrisë efikasitetin dhe cilësinë e punës në përmbushjen e rolit të saj. Raporti i dytë pasqyron gjetjet më të fundit nga vendimmarrjet, raportet institucionale dhe zhvillimet që kanë ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin e Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore.

Gjatë këtij gjashtëmujori, disa zhvillime kanë qenë veçanërisht të rëndësishme për analizën e këtij Raporti Monitorimi: miratimi i Raportit Vjetor të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024; miratimi i Raportit Vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2024; miratimi i Raportit Vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2024; si dhe publikimi i Raportit të Komisionit European mbi Shtetin e së Drejtës i vitit 2025. Të gjitha këto dokumente ofrojnë një perspektivë të re mbi ndryshimet institucionale dhe praktikat e ndjekura nga Prokuroria e Apelit, duke sjellë në vëmendje elementë që nuk ishin të disponueshëm deri në mars 2025, kur u përmbyll periudha e parë e monitorimit. Për këtë arsye, analiza e tyre për herë të parë është përfshirë në këtë Raport të Dytë, i cili njëkohësisht shqyrton edhe mënyrën se si këto vendimmarrje dhe raporte ndikojnë në forcimin ose sfidojnë ushtrimin e funksioneve të kësaj prokurorie.

Ky raport ndërtohet mbi bazën e punës së Raportit të Parë të Monitorimit, duke vijuar diskutimin mbi zhvillimet e reja, sfidat dhe përmirësimet që kanë dalë në pah lidhur me çështjet e trajtuara më parë. Disa sfida që mbeten të pandryshueshme në krahasim me gjetjet e Raportit të Parë, përmenden më mënyrë më të përmbledhur, duke qenë se janë trajtuar në Raportin e Parë në mënyrë të elaboruar. Në vijim, ky Raport fokusohet në trajtimin e disa temave thelbësore për funksionimin e sistemit të drejtësisë, si rëndësia e zbatimit të parimeve të shtetit të së drejtës dhe përcaktimi i qartë i rregullave konkrete për zbatimin e tyre. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar gjithashtu analizës së garancive që parashikon Neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), duke i shqyrtuar këto elemente në funksion të transparencës, paanshmërisë, llogaridhënies, shmangies së vonesave dhe aspekte të tjera të respektimit të procesit të rregullt ligjor.

II. Eficenca në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

II.1 Kohëzgjatja e procedurave në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Nevoja për rritjen e efencës në Prokurorinë e Apelit ka qenë një nga arsyet e draftimit dhe miratimit të hartës së re gjyqësore. Në këtë kuadër, vlerësimi i të dhënave sasiore dhe cilësore që shërbejnë si tregues për efencën është e një rëndësie themelore. Po ashtu, rritja e efencës në luftën kundër kriminalitetit ka qenë ndër qëllimet kryesore në punën e kësaj prokurorie edhe përgjatë vitit 2024, ashtu sic konfirmohet nga Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorisë së Apelit Nr. 01, datë 31.05.2024 'Për zbatimin e Udhëzimit Nr. 05, datë 16.05.2024 të Prokurorit të Përgjithshëm nxjerrë mbi vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 243 datë 17.04.2024 'Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024'.

Në vijim të Raportit të Parë, i cili është ndalur në mënyrë të detajuar në parashikimet normative ligjore dhe nënligjore të përcaktimit të afateve dhe kohëzgjatjes së ndjekjes penale në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nga momenti i shortimit të prokurorit deri në momentin e rekursit të çështjes në Gjykatën e Lartë apo ekzekutimin e çështjes në mungesë rekursi, ky Raport i Dytë do të synojë të sjellë vlerësime të reja lidhur me veprimtarinë e PA gjatë harkut kohor që përfshin raportin.

II.1.1 Aspekte të kohëzgjatjes së procedurave

Lidhur me vonesat në procedura në *përgjithësi* për sistemin e prokurorisë, KLP ka evidentuar në Raportin e vlerësimit për veprimtarinë e vlerësimit të prokurorëve nga KLP në vitin 2024, si një ndër çështjet më të rëndësishme, faktin që mangësitë në disa raste në dokumentacionin hetimor dhe **vonesa në marrjen e informacionit**, kanë ndikuar në cilësinë e vendimeve procedurale.¹ Megjithatë ky vlerësim lidhet me sistemin e prokurorisë në përgjithësi, jo në mënyrë të posaçme me Prokurorinë e Apelit.

Në përgjithësi, raporti vjetor mbi ecurinë e punës së Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024 ka vlerësuar se **nuk ka patur vonesa substanciale** në procedurat e ndjekura nga prokurorët e kësaj prokurorie. Tregues për këtë është fakti që gjatë vitit 2024 nuk ka nisur asnjë procedim disiplinor ndaj prokurorëve të Prokurorisë së Apelit apo punonjësve të tjerë të kësaj prokurorie për mosrespektimin e afateve ligjore.² Megjithatë, numri i reduktuar i prokurorëve ka potencialin të shkaktojë vonesa në ndjekjen e proceseve gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, jo të shkaktuara nga neglizhenca e prokurorëve, por nga përplasjet e çështjeve të shumta që ndjek secili prokuror i apelit.

II.1.2 Aplikimi i dënimeve alternative

Dënimet alternative mund të rrisin efikasitetin e punës së prokurorisë, duke shkurtuar kohën e procedimit, ulur kostot, nxitur rehabilitimin e autorëve dhe ofruar një përgjigje më humane ndaj kriminalitetit, kur plotësohen kushtet e parashikuara me ligj. Vendimmarrja për dënimet alternative i takon gjykatës, ndërsa prokurori mund të propozojë ndryshime.

Prokuroria e Apelit gjatë vitit 2024 ka inkurajuar vendosjen e dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore.³ Pavarësisht se raporti i vitit 2024 nuk paraqet shifra konkrete lidhur me numrin e dënimeve alternative të propozuara, në këndvështrim krahasimor me raportin e vitit 2023 të kësaj prokurorie, duket se gjatë periudhës së këtij monitorimi i është kushtuar një vëmendje e shtuar caktimit të dënimeve alternative jo vetëm për të miturit (si përmendet në raportin e vitit 2023), por edhe për grupe të tjerë vulnerabël, apo ata me probleme shëndetësore. Ky zhvillim vlerësohet pozitiv, si një mekanizëm në mbrojtje të të drejtave të njeriut, por njëkohësisht edhe një mënyrë për të shkurtuar kohën e procedurave dhe rritjen e efikasitetit të punës në prokurori. Në vijim është e nevojshme të specifikohen më qartë në raporte statistika konkrete lidhur me numrin e dënimeve

¹ Raporti i vlerësimit për veprimtarinë e vlerësimit të prokurorëve nga KLP në vitin 2024, faqe 2.

² Ibid.

³ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 39.

alternative të propozuara, si dhe kriteret që duhet të plotësohen për t'iu nënshtruar këtyre dënimeve.

II.1.3 Adoptimi i një numri unik të çështjes në sistemin e prokurorisë dhe gjykatave

Ashtu sic është evidentuar edhe në Raportin e Parë të Monitorimit (mars 2025), ende nuk ka një numër unik të çështjeve, i cili të jetë i pandryshueshëm përgjatë gjithë procedurave që kalon një dosje. Është e nevojshme, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe shpejtësisë në menaxhimin e çështjeve, që çështjet të kenë një **numër të pandryshuar**, i cili mund të caktohet në momentin kur dosja regjistrohet pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, dhe vijon të jetë i njëjti edhe kur i referohet Gjykatës së Shkallës së Parë, Prokurorisë së Apelit, Gjykatës së Apelit, Prokurorisë së Përgjithshme apo Gjykatës së Lartë.

Përdorimi i një numri unik të çështjes përfaqëson një element thelbësor për garantimin e identifikimit të saktë dhe të lehtë të dosjeve, duke mundësuar një ndjekje të vazhdueshme dhe efikase të çështjes gjatë gjithë rrugëtimit të saj në sistemin gjyqësor. Një numër unik identifikues siguron që të gjitha dokumentet, provat materiale, aktet procedurale dhe çdo e dhënë tjetër e lidhur me rastin të organizohen e të menaxhohen në mënyrë të qartë dhe koherente, duke shmangur paqartësitë administrative. Ky mekanizëm jo vetëm që lehtëson komunikimin e brendshëm dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë (si prokuroria, gjykatat, apo policia gjyqësore) por gjithashtu minimizon vonesat dhe redukton rrezikun e gabimeve administrative apo teknike. Në këtë mënyrë, secili institucion që merr pjesë në trajtimin e çështjes ka mundësi të gjurmojë në mënyrë transparente dhe të besueshme ecurinë e saj, pa pasur nevojë për përshtatje apo ndryshim të numrit të dosjes në varësi të fazës së procesit apo institucionit përkatës, apo për të shpenzuar kohë me komunikime midis organeve të ndryshme të drejtësisë për të identifikuar të dhëna të caktuara të dosjeve. Standardizimi i kësaj praktike është thelbësor për të garantuar një sistem drejtësie më të unifikuar, më efikas dhe më të besueshëm, duke forcuar njëkohësisht sigurinë juridike dhe transparencën e organeve të drejtësisë.

II.1.4 Konkluzione lidhur me masat për shmangien e vonesave në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Ndonëse sistemi i prokurorisë në përgjithësi është përballur me sfida lidhur me dokumentacionin hetimor dhe vonesat në marrjen e informacionit, Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm *nuk ka raportuar probleme substanciale* në respektimin e afateve ligjore gjatë vitit 2024. Mungesa e procedimeve disiplinore tregon disiplinë institucionale, por numri i reduktuar i prokurorëve faktikë në këtë prokurori mbetet një faktor që mund të ndikojë në ecurinë e proceseve gjyqësore për shkak të mbingarkesës së dosjeve.

Propozimi i *dënimeve alternative* nga prokuroria ka potencialin të sjellë një përmirësim në kohëzgjatje dhe kosto të procesit penal, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e efikasitetit të punës në prokurori.

Një masë e nevojshme për reduktimin e vonesave burokratike dhe procedurale është adoptimi i një *numri unik të çështjes*, i cili, si është diskutuar më me hollësi në Raportin e Parë të Monitorimit, përcaktohet në momentin kur ndërtohet dosja në Prokurorinë e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, dhe vijon të jetë i pandryshuar deri në përfundim të procesit

gjyqësor, në cilëndo shkallë të sistemit gjyqësor, duke ofruar lehtësi për komunikimin e administratave të prokurorive dhe gjykatave të ndryshme, si dhe për vetë punën e prokurorëve. Ashtu si më parë, edhe në këtë gjashtëmujor nuk janë evidentuar përpjekje për bashkëpunim në krijimin e një numri unik të çështjes.

II.2 Adresimi i vonesave në procedura

Edhe në vitin 2024, ashtu si në vitin paraardhës, PA ka vijuar të raportojë (përveç numrit të reduktuar të prokurorëve) edhe probleme logjistike të cilat shkaktojnë vonesa të tjera, si funksionimin në godinë të veçantë nga ajo e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, mbingarkesa e stafit administrativ me detyrat e fotokopjimit të dosjeve voluminoze krahas realizimit të detyrave të tjera administrative⁴. Në këtë kuadër, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi të Drejtat e Njeriut për vitin 2024 ka theksuar se „...mungesa e gjyqtarëve dhe prokurorëve vonoi procedurat penale. Burimet e kufizuara materiale, mungesa e hapësirës, menaxhimi i dobët i kalendarit gjyqësor, stafi i pamjaftueshëm dhe mosparaqitja e avokatëve dhe dëshmitarëve gjithashtu e penguan sistemin gjyqësor të gjykonte çështjet në kohën e duhur“⁵.

II.2.1 Masat e marra për shmangien e vonesave në procedura

Për shkak të mbingarkesës së prurjes së çështjeve në raport me numrin e reduktuar të prokurorëve, Raporti Vjetor i kësaj Prokurorie për vitin 2024 ka theksuar se i është dhënë prioritet gjykimeve penale me persona të cilët janë në masën e sigurimit 'arrest me burg', dhe ato që kanë të bëjnë me ekstradimin dhe njohjet e vendimeve penale të huaja.⁶ Pra, çështjet që dalin për shqyrtim janë të kushtëzuara nga masa e sigurimit, dhe nevoja për respektimin e të drejtave procedurale, sidomos të personave nën arrest. Kjo është një zgjidhje racionale por vetëm momentale, pasi parimi i respektimit të procesit të rregullt ligjor (përfshirë këtu respektimin e afateve procedurale dhe procedimin pa vonesa) është një e drejtë themelore e njeriut, dhe si e tillë duhet të zbatohet në çdo rast, edhe në kushtet e një mase sigurimi që nuk përfshin arrestin me burg.

Gjatë vitit 2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit ka marrë masa për shmangien e vonesave në procedura, duke marrë parasysh numrin e reduktuar të prokurorëve faktikë në këtë prokurori. Sipas raportit të kësaj prokurorie për vitin 2024, janë respektuar me korrektesë: detyrimet e ligjit procedural penal, si dhe urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm për respektimin e afateve në shqyrtimin e çështjeve të ankimuara, kryesisht lidhur me prezencën e prokurorëve në të gjitha seancat gjyqësore; nxjerrjen në kohë të urdhërave të ekzekutimit në zbatim të vendimeve të Gjykatës së Apelit; dërgimin e vendimeve penale në Prokuroritë kompetente të Rretheve Gjyqësore; dhe ushtrimin brenda afateve ligjore të rekursit në Gjykatën e Lartë (GJL).⁷

⁴ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 3.

⁵ Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi të Drejtat e Njeriut për vitin 2024, faqe 10.

⁶ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 40.

⁷ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 40.

II.2.2 Administrimi i prokurorisë

Efienca në punën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit matet jo vetëm me punën individuale të secilit prokuror, por edhe me efikasitetin në funksionimin dhe organizimin e administratës në mbështetje të punës së kësaj prokurorie. Në të njëjtën mënyrë sic përmendej edhe në raportin e vjetshëm të kësaj prokurorie, edhe raporti i fundit për vitin 2024 rikonfirmon një personel administrativ të kufizuar numerikisht.⁸ Një tjetër problem me ndikim të ndjeshëm në efencën e punës së administratës është vendi vakant për më shumë se katër vjet i Kancelarit të kësaj prokurorie, çka, sipas raportit të mësipërm, ka sjellë problematika në mirëfunksionimin e administratës së kësaj prokurorie.⁹ Një tjetër problematikë e vënë në dukje nga raporti vjetor i kësaj prokurorie për vitin 2024 është nevoja për shtim personeli të specializuar për arkivat, në kushtet që pas riorganizimit të hartës gjyqësore kjo prokurori duhet të administrojë arkivat e ish prokurorive të apelit në rrethe.¹⁰

Një tjetër aspekt i trajtuar edhe në Raportin e Parë të Monitorimit të punës së Prokurorisë së Apelit është edhe fakti që gjykata e Apelit dhe Prokuroria pranë kësaj gjykate nuk ndodhen në të njëjtën godinë, duke shtuar kohën e shpenzuar nga prokurorët për transport. Lidhur me këtë problem, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë (2024-2030) është shprehur se KLGJ dhe Prokuroria e Përgjithshme kanë finalizuar dokumentin e Detyrës së Projektimit për ndërtimin e një godine të përbashkët për Gjykatën dhe Prokurorinë e Apelit.¹¹

II.2.3 Konkluzione për trajtimin e vonesave në procedura

Raporti vjetor për vitin 2024 evidenton se Prokuroria e Apelit ka ndërmarrë masa për shmangien e vonesave, duke respektuar afatet procedurale dhe duke siguruar prezencën e prokurorëve në seancat gjyqësore, ekzekutimin në kohë të vendimeve dhe ushtrimin e rekursit brenda afateve ligjore. Fakti që u është dhënë prioritet gjykimeve penale me persona të cilët janë në masën e sigurimit 'arrest me burg' duhet të konsiderohet si një zgjidhje momentale në kushtet e një mbingarkese dhe vakancash prokurorësh, pasi një zbatim afatgjatë i këtij parimi cenon garancitë e parashikuara nga e drejta për një proces të rregullt ligjor. Gjithashtu, efikasiteti i institucionit mbetet i kushtëzuar nga mungesa e personelit administrativ, vendi vakant i kancelarit prej më shumë se katër vitesh dhe nevoja për staf të specializuar në menaxhimin e arkivave pas riorganizimit të hartës gjyqësore. Gjithashtu, ndarja fizike mes Gjykatës së Apelit dhe Prokurorisë pranë saj vijon të jetë një pengesë praktike, megjithëse Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë ka parashikuar ndërtimin e një godine të përbashkët për të adresuar këtë problem.

⁸ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 43.

⁹ Ibid.

¹⁰ Ibid.

¹¹ Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030 dhe Draft Raporti i Monitorimit janar-dhjetor 2024, https://www.drejtesia.gov.al/ëp-content/uploads/2025/06/SND-Raport_-Janar-Dhjetor-2024-final.pdf, faqe 108.

II.3 Kategorizimi i çështjeve

II.3.1 Kategorizimi aktual i çështjeve në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Ashtu siç është shtjelluar më gjatë në Raportin e Parë të Monitorimit, legjislacioni shqiptar parashikon një lloj kategorizimi të çështjeve para se ato të bëhen pjesë e juridiksionit të një gjykate, si për shembull parashikimi i Nenit 135(1) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton çështjet nën juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).

Gjithashtu, edhe brenda Prokurorisë së Apelit, ndarja e çështjeve të themelit nga ana e drejtuesit të prokurorisë realizohet duke marrë parasysh kriteret e numrit të çështjeve për prokuror, shkallës së rrezikshmërisë dhe rëndësisë së çështjes, numrit të të pandehurve, si dhe nëse çështja gjykohet në apel mbi bazën e ankimeve të prokurorëve, apo ankimeve të bëra nga ana e palëve të tjera në procesin penal.¹² I njëjti qëndrim është konfirmuar edhe në Raportin mbi Ecurinë e Punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024.¹³ Kjo formë e kategorizimit të çështjeve nuk është e rregulluar në një akt normativ, dhe nuk ka rregulla specifike lidhur me kriteret e ndarjes së çështjeve apo procedurës që duhet të ndjekë drejtuesi i prokurorisë. Si pasojë, kjo qasje mbështetet më shumë në praktikën e brendshme të kësaj prokurorie, gjë që mund të krijojë hapësirë për mospërputhje, ose mungesë uniformiteti në shpërndarjen e çështjeve ndërmjet prokurorëve të ndryshëm. Një rregullim më i qartë dhe i standardizuar i kësaj procedure do të mund të kontribuonte në rritjen e transparencës, unifikimit edhe formal të procedurës dhe thjeshtëzimit të sfidave që sjell ndarja manuale e çështjeve.

II.3.2 Mungesa e një metodologjie të qartë lidhur me kategorizimin e çështjeve sipas kompleksitetit të tyre

Sipar Raportit të 'Rule of Law' Për Shqipërinë për vitin 2025, edhe pse rregullat për caktimin me short të çështjeve mbetën në fuqi, për shkak të vonësive të vazhdueshme në plotësimin e vendeve të lira gjyqësore në disa gjykata, caktimi rastësor i çështjeve ende nuk zbatohet në mënyrë të vazhdueshme në prokurori, me përjashtim të disa përpyekjeve që janë bërë në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.¹⁴

Në panelin e diskutimit mbi Raportin e Parë të Monitorimit (prill 2025) përfaqësues nga Prokuroria e Apelit u shprehën se kategorizimi i çështjeve aplikohet në këtë prokurori, me qëllim shpërndarjen uniforme të çështjeve mes prokurorëve. Ashtu siç është propozuar edhe në Raportin e Parë të Monitorimit, edhe ky Raport i Dytë i qendron mendimit se përdorimi i një metodologjie të 'case weighting' (peshimit të çështjeve), siç rekomandohet edhe nga CEPEJ¹⁵ do të ishte një zgjidhje në favor të rritjes së efikasitetit në prokurori. Teknika e 'case weighting' përcaktohet nga vetë institucioni përgjegjës përmes një rregulloreje dhe konsiston në përdorimin e indekseve dhe pikëzimit për indikatorë të ndryshëm të secilës çështje, duke marrë

¹² Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 22.

¹³ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 3.

¹⁴ Raporti i 'Rule of Law' I Komisionit European për Shqipërinë, (2025), faqe 4.

¹⁵ Council of Europe, CEPEJ, Case Weighting in European Justice Systems, 2018, https://rm.coe.int/cepej-saturn-2017-7erev10e-case-weighing/16808ccb22#_Toc510802389

parasysh elementë si pranimi ose jo i akuzës, nevoja për ekspertiza apo përkthime, numri i dëshmitarëve dhe viktimave, kohëzgjatja e çështjeve të ngjashme dhe rëndësia kombëtare apo ndërkombëtare e rastit.

II.3.3 Konkluzione për kategorizimin e çështjeve

Aktualisht Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm zbaton një formë kategorizimi të çështjeve nëpërmjet ndarjes së tyre nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, në bazë të disa kritereve, si: numri i çështjeve për prokuror; shkallës së rrezikshmërisë dhe rëndësisë së çështjes, si dhe nëse çështja gjykohet në apel mbi bazën e ankimeve të prokurorëve apo ankimeve të bëra nga ana e palëve të tjera në procesin penal. Megjithatë, nuk ka ende një rregullore lidhur me metodën e kategorizimit të çështjeve, për të unifikuar këtë praktikë. Metoda e sugjeruar, bazuar edhe në rekomandimet e CEPEJ është ajo e peshimit të çështjeve, ose 'case weighting', e cila përdor sistemin e indekseve dhe pikëzimit, për të arritur një rezultat sa më uniform të shpërndarjes së çështjeve mes prokurorëve.

II.4 Ndikimi i hartës së re gjyqësore në efencën e punës së PA

II.4.1 Numri aktual i prokurorëve pranë Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Harta e re gjyqësore filloi të aplikohet në sistemin gjyqësor shqiptar nga 1 shkurti 2023, duke sjellë ndryshime thelbësore, nga të cilat më i rëndësishmi ishte ndërprerja e veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatave të Apelit Shkodër, Durrës, Korçë, Vlorë, dhe Gjirokastrë. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (e riemërtuar me Urdhërin Nr.9, datë 18.1.2023) vazhdoi funksionimin pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me kompetenca tokësore në gjithë territorin e vendit.


Ashtu siç është evidentuar në Raportin e Parë të Monitorimit për Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokuroria e Përgjithshme miratoi Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 01 datë 26.01.2023 'Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm'. Ky udhëzim thekson nevojën për marrjen e masave të duhura procedurale penale për zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor, në garantimin e lirive dhe të drejtave të personave me masë sigurimi personal, personave nën hetim, të pandehurve dhe/ose viktimave të procedimit penal gjatë periudhës dhe/ose procedurës së mbartjes së akteve, procedimeve apo çështjeve në prokuroritë kompetente sipas ligjit dhe normimeve të këtij udhëzimi të përgjithshëm.¹⁶

Pavarësisht se me përqendrimin e organit të akuzës në nivel apeli në një institucion të vetëm volumni i punës është rritur ndjeshëm, kjo prokurori edhe gjatë vitit 2024 ka vijuar të punojë me një numër të reduktuar prokurorësh, dhjetë të tillë.¹⁷ Një numër faktik sa 50% e numrit të miratuar të prokurorëve ka një efekt negativ në rritjen e efikasitetit të punës së kësaj prokurorie. Nga ana tjetër, Raporti i PA për vitin 2024 evidenton një rritje të numrit të çështjeve prej

¹⁶ Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 01 datë 26.01.2023 'Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm', Neni 10.

¹⁷ Prokuroria e Apelit, Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 3.

17,72%,¹⁸ një rritje e ndjeshme në çdo rast, për më tepër në kushtet kur numri i prokurorëve mbetet i njëjtë dhe në rreth 50% të kapacitetit normal.



Burimi: Raportet vjetore të KLP dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Sikurse shihet nga grafiku më sipër, Prokuroria e Apelit vijon të karakterizohet nga një numër i lartë vakancash, pasi afërsisht 50% e numrit të miratuar të prokurorëve është në mungesë. Për këtë arsye, gjatë vitit 2024 është caktuar përkohësisht nga ana e KLP-së një prokuror nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës e Parë në Prokurorinë e Apelit,¹⁹ megjithatë, numri i prokurorëve është ende shumë i pakët në raport me punën voluminoze të ndjekjes penale në apel në rang republike.

II.4.2 Ngarkesa e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm


Sipas të dhenave të Prokurorisë së Përgjithshme, ngarkesa e punës së Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është shtuar në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023. Gjatë vitit 2024, kjo prokurori ka shqyrtuar *2630 masa sigurimi personal* dhe *1667 çështje themeli*,²⁰ respektivisht 260 masa sigurimi më shumë dhe 322 çështje themeli më shumë në krahasim me vitin 2023. Sipas Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2024, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 1667 çështje themeli (rritje prej 23,94% në krahasim me vitin 2023) dhe 2630 raste për masat e sigurimit personal (rritje prej 10,97% në krahasim me vitin 2023).²¹

¹⁸ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 5.

¹⁹ Raporti vjetor i KLP për vitin 2024, faqe 36.

²⁰ Raporti vjetor i PP për vitin 2024, faqe 12.

²¹ Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2024, faqe 45.



Në total, numri i çështjeve të shqyrtuara nga kjo prokurori është rritur me rreth 15,7% gjatë vitit 2024. Kjo rritje e dukshme ngarkese nuk është shoqëruar me një shtim të ngjashëm të numrit të prokurorëve faktikë në këtë prokurori, dhe as të stafit administrativ. Ngarkesa mesatare për prokurorë faktikë në vitin 2024, për Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm rezulton të jetë 391 çështje,²² një ngarkesë e lartë, në krahasim me 215²³ çështje në vit që është mesatarja e çështjeve që do të kishte secili prokuror, në kushtet kur numri faktik i tyre do të ishte i njëjtë me numrin e miratuar në organikë. Ky shtim i ndjeshëm i ngarkesës së prokurorëve të Apelit mund të ndikojë në cilësinë dhe eficientë të punës së kësaj prokurorie.

II.4.3 Konkluzione lidhur me ndikimin e hartës së re gjyqësore në eficientë të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Nga analiza më sipër vihet re një rritje e ngarkesës së çështjeve të trajtuara nga Prokuroria e Apelit nga viti 2023 në 2024. Kjo ngarkesë nuk është shoqëruar me të njëjtin nivel të rritjes së numrit të prokurorëve në këtë prokurori, duke qenë se ndryshimi i vetëm ka qenë caktimi përkohësisht nga ana e KLP-së i një prokurori nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës e Parë. Ngarkesa e lartë 391 çështje për prokuror, nga mesatarja e 215 çështjeve, është treguesi më i qartë i mbingarkesës së kësaj prokurorie, gjendje e cila mund të sjellë probleme si lidhur me menaxhimin eficient të kohës, ashtu edhe me cilësinë e punës së prokurorëve. Po ashtu, numri i punonjësve të administratës së prokurorisë nuk është rritur në përputhje me rritjen e volumit të punës.

II.5 Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit

II.5.1 Sfidat e përdorimit të një sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Deri në shtator të vitit 2025, sistemi i prokurorisë në përgjithësi, përfshirë edhe Prokurorinë e Apelit, nuk ka të vendosur në përdorim një sistem elektronik të menaxhimit të çështjeve. Ashtu si është evidentuar edhe në Raportin e Parë të Monitorimit të punës së Prokurorisë së Apelit (mars 2025), kjo prokurori ende nuk ka një sistem elektronik të aksesueshëm nga prokurorët

²² Raporti vjetor i PP për vitin 2024, faqe 13.

²³ Raporti vjetor i PP për vitin 2024, faqe 18.

për të marrë informacion elektronikisht dhe në kohë të shkurtër lidhur me afatet, përmbajtjen e dosjes dhe të dhëna të tjera të rëndësishme të çështjeve. Lidhur me përpunimin e të dhënave dhe gjenerimin e statistikave, Prokuroria e Apelit ka zyrën e statistikave, e cila mbledh dhe përpunon të dhëna lidhur me ngarkesën e prokurorëve, kohëzgjatjen e procedurave, llojet e çështjeve të ndjekura në Gjykatën e Apelit, rekursat pranë Gjykatës së Lartë, etj. Megjithatë, përpunimi i të dhënave nuk është automatik përmes një sistemi, por realizohet kryesisht manualisht nga punonjësit përgjegjës.

Lidhur me sa më sipër, Strategjia Ndërsëktoriale e Drejtësisë (SND) 2024-2030, është shprehur se vonesat në ndërtimin e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve paraqesin një risk të konsiderueshëm, në vënien në funksion të këtij sistemi.²⁴ Nevoja për zhvillimin e sistemeve teknologjike për menaxhimin e çështjeve dhe digjitalizimin e arkivave të sistemit të prokurorisë është njohur edhe nga Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për Raportin Vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për Vitin 2023”.²⁵ Po ashtu, një nga rekomandimet e Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2025 është vijimi i bashkëpunimit të grupit të punës në Prokurorinë e Përgjithshme me përfaqësuesit e UNOPS, në gjithë proceset e nevojshme për krijimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve; si dhe vijimi i bashkërendimit dhe koordinimit të strukturave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori me standarde ndërkombëtare.²⁶

II.5.2 Zhvillimet e fundit lidhur me menaxhimin elektronik të të dhënave në prokurori

KLP ka përpiluar për herë të parë një **databazë elektronike** lidhur me **menaxhimin e burimeve njerëzore** të sistemit të prokurorisë, e cila përmban të dhëna në lidhje me përbërjen e secilës prej zyrave të prokurorive, procedurat nëpërmjet të së cilave janë caktuar, emëruar apo transferuar prokurorët, datën e emërimit, me vjetërsinë në punë, moshën e magjistratëve, raportet gjinore etj., të cilat përditësohen në kohë reale dhe ndihmojnë në analizën rast pas rasti të lëvizjeve qoftë nëpërmjet caktimit të përkohshëm, komandimit, transferimit, lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë të prokurorëve.²⁷ Qëllimi i krijimit të kësaj databaze ka qenë nevoja për të pasur një panoramë sa më të plotë dhe të qartë, duke pasur parasysh edhe dinamikën e ndryshimit të përbërjes së zyrave të prokurorive për shkak të largimeve të shumta të prokurorëve, kryesisht për shkak të vetingut.²⁸ Kjo databazë elektronike e krijuar nga KLP përbën një instrument thelbësor për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin e prokurorisë, pasi centralizon dhe përditëson në kohë reale të dhëna mbi përbërjen, lëvizjet dhe karrierën e prokurorëve. Ajo siguron rritjen e transparencës dhe objektivitetit në procedurat e emërimit, transferimit apo ngritjes në detyrë, duke mundësuar një analizë të plotë mbi shpërndarjen sipas moshës, vjetërsisë dhe përfaqësimit gjinor. Kjo databazë ka potencialin të kontribuojë në rritjen e efikasitetit, profesionalizimit dhe llogaridhënies së sistemit, duke shërbyer si bazë për planifikimin strategjik dhe përf forcimin e meritokracisë.

²⁴ SND 2024-2030, faqe 22.

²⁵ Rekomandimet Nr. 5 dhe Nr. 10 të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për Raportin Vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për Vitin 2023”

²⁶ Raporti vjetor i PP (2024), faqe 20.

²⁷ Raporti vjetor i KLP (2024), faqe 31.

²⁸ Ibid.

Në ndihmë të menaxhimit elektronik të çështjeve të prokurorisë është përgatitur edhe projekti në partneritet midis BE-së dhe UNOPS me qëllim përforcimin e sistemit gjyqësor të Shqipërisë. Për të adresuar sfida si proceset e zgjatura, menaxhimi i fragmentuar i çështjeve dhe përdorimi i kufizuar i teknologjisë, Bashkimi Europian ka nisur projektin EU4Digital Justice të quajtur “Mbështetje për Sundimin e Ligjit përmes Transformimit Digjital”. Me një buxhet prej 7.5 milionë Eurosh, kjo iniciativë katërvjeçare, që do të zbatohet nga UNOPS, do të prezantojë një sistem modern dhe të unifikuar të menaxhimit të çështjeve për prokurorinë. Gjithashtu, do të zbatohet mjete të analizës së të dhënave për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në prova dhe për të përmirësuar ndërveprimin midis institucioneve gjyqësore.²⁹

II.5.3 Konkluzione për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Prokurorinë e Apelit

Zbatimi i teknologjisë së informacionit në menaxhimin e çështjeve në sistemin gjyqësor në përgjithësi është jo vetëm i sugjeruar, por i domosdoshëm për të arritur nivelin e pritshëm të efikasitetit të punës së gjykatave dhe prokurorisë. Megjithatë parashikimet ligjore, sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk është ende i zbatueshëm. Një zhvillim pozitiv në drejtim të mirëmenaxhimit të burimeve njerëzore të prokurorisë ka qenë krijimi nga KLP i një databaze elektronike, e cila përmban të dhëna në lidhje me përbërjen e secilës prej zyrave të prokurorisë, procedurat nëpërmjet të cilave janë caktuar, emëruar apo transferuar prokurorët, datën e emërimit, me vjetërsinë në punë, moshën e magistratëve, raportet gjinore etj, çka do të përshtejtojë dhe lehtësojë procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore. Një zhvillim pozitiv është gjithashtu miratimi i projektit EU4Digital Justice “Mbështetje për Sundimin e Ligjit përmes Transformimit Digjital” që do të zbatohet nga UNOPS, dhe synon të prezantojë një sistem modern dhe të unifikuar të menaxhimit të çështjeve për prokurorinë.

III. Cilësia në punën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

III.1 Vlerësimi i prokurorëve nga KLP

Raporti i Parë i monitorimit mbi efikasitetin dhe cilësinë e punës së Prokurorisë së Apelit prezantoi kriteret e vlerësimit etik e profesional të prokurorëve të Gjykatës së Apelit (duke përfshirë: aftësitë profesionale të prokurorit; aftësitë organizative; etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale të prokurorisë; aftësitë personale dhe angazhimin profesional), si edhe statistikën e këtij vlerësimi deri në fillim të vitit 2024. Ky Raport i Dytë do të fokusohet tek ndryshimet e procedurës së këtij vlerësimi, impaktin që mund të kenë në efikasitetin dhe cilësinë e punës së prokurorëve, dhe risitë që ka sjellë viti 2024 në këtë kuadër.

III.1.1 Aktualiteti i vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve nga KLP

Vlerësimi i prokurorëve në Republikën e Shqipërisë është kompetencë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP).³⁰ Gjithashtu, ligji 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë' parashikon se Këshilli (në këtë rast, KLP), jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, miraton programin që përcakton listën e magistratëve dhe kryetarëve, për të cilët do të kryhet

²⁹ EU4 Digital Justice: EU and UNOPS Partnership to Strengthen Albania's Justice System, Qershor 2025, <https://www.unops.org/neës-and-stories/neës/eu4digital-justice-eu-and-unops-partnership-to-strengthen-albanias-justice-system>.

³⁰ Neni 149/a (1)(a) i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

vlerësimi përgjatë vitit pasardhës dhe periudhën e vlerësimit. Në program përfshihen të paktën ata magjistratë, për të cilët përfundon ose ka përfunduar periudha e vlerësimit në vitin përkatës, me qëllim që të sigurohet në kohë vlerësimi etik dhe profesional i magjistratit.³¹ Posaçërisht, vlerësimi etik dhe profesional i prokurorëve është kompetencë e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale brenda KLP-së. Ky proces ka si qëllim vlerësimin e vazhdueshëm të etikës dhe aftësive profesionale të prokurorit, zhvillimin e karrierës mbi bazën e meritës, identifikimin sa më mirë të nevojave për kualifikimin e mëtejshëm, si dhe përmirësimin e efikasitetit të zyrave të prokurorisë³².

Sipas Raportit vjetor të KLP-së për vitin 2023, ndër dyzet prokurorët e planifikuar për t'u vlerësuar, një ishte prokuror pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Për vitin 2024 u miratuan 5 vlerësime periodike etike dhe profesionale, 3 vlerësime të përsheptuara etike dhe profesionale, si dhe 1 vlerësim etiko-profesional për drejtues zyre të prokurorisë.³³ Deri në shkurt 2025, **një prej prokurorëve** të kësaj prokurorie (drejtuesi i prokurorisë) i është nënshtruar vlerësimit etik dhe profesional nga KLP. Numri i prokurorëve të Prokurorisë së Apelit që i janë nënshtruar vlerësimit etik dhe profesional nuk ka ndryshuar në gjashtë-mujorin e fundit, dhe qendron i njëjtë më atë të diskutuar në Raportin e Parë të Monitorimit të Prokurorisë së Apelit.

III.1.2 Ndryshimi i rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve

Një zhvillim i rëndësishëm në drejtim të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve gjatë vitit 2024 kanë qenë **disa ndryshime të Rregullores 'Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve'**³⁴. Raporti vjetor i KLP për vitin 2023 shprehu shqetësimin që gjatë procesit të vlerësimit ishin hasur vështirësi në plotësimin e tabelave sipas anekseve të Rregullores së Vlerësimit nga prokuroritë, në të cilat kanë ushtruar funksionin prokurorët e shortuar për vlerësim. Ky ndërhyrje ka sjellë dhe vonesa në kryerjen në afat të këtij procesi.³⁵ Kjo problematikë u nënvizua edhe nga Raporti për 'Rule of Law' lidhur me Shqipërinë, i cili theksoi se KLGJ dhe KLP vazhdojnë të përballen me sfida në sigurimin e vlerësimeve të performancës së magjistratëve në kohë dhe cilësi³⁶.

Bazuar në këto problematika dhe në vlerësimet e kryera nga ekspertët, u gjykua e nevojshme që KLP të ndërmarrë disa hapa, me qëllim përsheptimin e këtij procesi për të garantuar përfundimin e tij në kohë, të paktën për periudhën e vlerësimit për vitet 2017-2021³⁷. Të ndodhur në situatën e problemeve për zbatimin e parimit të efikasitetit, si dhe bazuar në nismën konkrete të ndërmarrë nga ekspertët e projektit EU4JUSTICE, pasi u zhvilluan disa takime të përbashkëta, u dakordësua për disa ndryshime në Rregulloren e Vlerësimit të Prokurorëve duke pranuar nevojën për të kryer ndërhyrje të pjesshme, të një karakteri emergjent, për përsheptimin e procesit të vlerësimit, pa ndryshuar në mënyrë thelbësore rregulloren dhe

³¹ Neni 85 i ligjit Nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'.

³² Raporti vjetor i KLP (2023), faqe 53.

³³ Ibid.

³⁴ Rregullorja Nr. 95 datë 09.05.2022 'Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve'.

³⁵ Raporti Vjetor i KLP (2023), faqe 54.

³⁶ Raporti i 'Rule of Law' i Komisionit European për Shqipërinë (2025), faqe 3.

³⁷ Raporti Vjetor i KLP (2024), faqe 25.

metodologjinë e saj dhe pa cënuar parashikimet ligjore mbi procesin e vlerësimit të prokurorëve³⁸.

Për të adresuar këtë problem, u vlerësua nga KLP që pa cënuar formatin e tabelave statistikore të Rregullores së Vlerësimit, të reduktohet plotësimi i disa rubrikave që duhet të plotësohen nga prokuroritë, rubrika të cilat janë të lidhura me të dhënat e marrjes së materialit, datës së dorëzimit të tij, afateve ligjore, mesatares dhe rendimentit, etj., të cilat do të *shkurtojnë kohën e përpunimit të statistikave* nga prokuroritë përkatëse³⁹. KLP me Vendimin Nr.100, datë 18.06.2024, miratoi ndryshimet e Rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, e cila ishte miratuar më parë me Vendimin Nr.95, datë 29.05.2022, ndërsa me Vendimin Nr.111, datë 27.06.2024, KLP-ja miratoi ndryshimet e ankeseve Nr.2, 5, 6 dhe tabelave përkatëse, pjesë integrale të Rregullores "Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve", e ndryshuar, çfarë dhe plotësoi kuadrin rregullator, me impakt direkt në fillimin nga KLP të procesit të vlerësimit të veprimtarisë së magjistratëve prokurorë.⁴⁰ Në këtë kuadër, janë vendosur standarde të reja për pikëzimin e treguesve, është thjeshtuar përpunimi i dokumentacionit dhe janë rishikuar mënyrat e vlerësimit për angazhimet shtesë të prokurorëve.⁴¹ Ky ndryshim ka potencialin të përmirësojë efikasitetin në vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve, duke kapërcyer ngërçin e kohëzgjatjes së procedurës dhe duke vijuar me ritme më të shpejta këtë proces shumë të rëndësishëm.

II.1.3 Konkluzione lidhur me vlerësimin e prokurorëve nga KLP

Vlerësimi etik dhe profesional i prokurorëve është një procedurë e nevojshme ndër të tjera për garantimin e cilësisë së punës së prokurorisë. Gjatë viteve 2024 dhe 2025, KLP ka realizuar me sukses vlerësimin etik dhe profesional të një numri të konsiderueshëm prokurorësh, ndër të cilët një prokuror nga Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (drejtuesi i kësaj prokurorie). Gjatë vitit 2024, KLP ndërmori ndryshime të pjesshme në Rregulloren “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve” për të adresuar vështirësitë dhe vonesat e hasura më parë në procesin e vlerësimit. Këto ndryshime synuan thjeshtimin e plotësimit të tabelave dhe reduktimin e disa rubrikave, duke ruajtur parashikimet ligjore dhe metodologjinë bazë. Ky ndryshim pritet të rrisë efikasitetin e vlerësimit, duke kapërcyer ngërçet procedurale dhe duke përshpejtuar një proces me rëndësi të veçantë për funksionimin e sistemit të drejtësisë në tërësi.

III. 2 Respektimi i parimit të procesit të rregullt ligjor (due process) nga Prokuroria e Apelit

III.2.1 Standardet e evidentuara në nivel kombëtar për të siguruar procesin e rregullt ligjor në përfaqësimin e akuzës nga Prokuroria e Apelit

Në Shqipëri ekziston një korpus i plotë ligjor, i cili përpiqet të garantojë respektimin e procesit të rregullt ligjor (ndër të tjera) nga prokuroria. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton pavarësinë e prokurorisë dhe mekanizmat për rregullimin e llogaridhënies, statusit, integritetit dhe paanësisë së prokurorëve.⁴² Ligji 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në

³⁸ Raporti Vjetor i KLP (2024), faqe 26.

³⁹ Raporti Vjetor i KLP (2024), faqe 27.

⁴⁰ Raporti Vjetor i KLP (2024), faqe 67.

⁴¹ Raporti i Vlerësimit për veprimtarinë e vlerësimit të prokurorëve që është kryer nga KLP në vitin 2024, faqe 2.

⁴² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 149.

Republikën e Shqipërisë' garanton ligjshmërinë e veprimtarisë, pavarësinë e prokurorëve, objektivitetin dhe barazinë gjatë ushtrimit të funksioneve, respektimin e parimit të konfidencialitetit të të dhënave, respektimin e rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale, etj.⁴³ Në të njëjtën linjë, ligji 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë' parashikon detyrimin e magjistratëve për të ushtruar funksionin në pavarësi, paanësi, drejtësi, duke respektuar standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, etj.⁴⁴ Po ashtu, edhe udhëzimet e Prokurorisë së Përgjithshme rregullojnë më tej detyrimin e prokurorëve për të ushtruar funksionin me transparencë dhe pavarësi⁴⁵.

Plani i Veprimit për Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024, bazohet në disa standarde, që shërbejnë si shtylla për të gjithë Planin. Këto parime lidhen, *ndër të tjera*, edhe me përmirësimin e rregullave procedurale gjatë veprimtarisë së Prokurorisë së Apelit. Disa nga parimet kryesore të cilat lidhen me procesin e rregullt ligjor janë si më poshtë:

Konsolidimi i pavarësisë institucionale dhe funksionale të PA dhe prokurorëve të saj

Pavarësia e prokurorëve (përfshirë prokurorët e apelit) garantohet nga KPrP;⁴⁶ ligji 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë';⁴⁷ ligji 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'⁴⁸ dhe akte të tjera normative me fuqi nënligjore, të miratuara në bazë dhe për zbatim të këtij kuadri ligjor. Po ashtu, pavarësia dhe paanësia e funksionit të prokurorit është pjesë e garancive të parashikuara nga Neni 6 i KEDNJ-së.

Rëndësia e pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje pasqyrohet edhe në pikët e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve. Nën rubrikën 'Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale' (në total 100 pikë), imuniteti ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, nderi dhe dinjiteti vlerësohen maksimalisht me 40 pikë, ndërsa mospërdorimi i gjuhës diskriminuese me maksimalisht 10 pikë. Programi tematik i Shkollës së Magjistraturës për trajnimin vazhdues 2024-2027 i kushton një vëmendje të veçantë pavarësisë dhe paanësisë së magjistratit, duke shtuar në kurrikul temën e 'Paragjykitimit dhe njëanshmërisë' dhe një tjetër mbi 'Paanshmërinë' në procesin gjyqësor.⁴⁹

Raporti vjetor i Prokurorisë së Apelit për vitin 2024 ka nënvizuar rëndësinë që i është dhënë gjatë këtij viti respektimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Rregullores 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë' në drejtim të

⁴³ Ligji Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë', Nenet 3-11.

⁴⁴ Ligji Nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', Nenet 3-11.

⁴⁵ Shiko për shembull: Udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme Nr. 12 datë 20.07.2020 'Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm'

⁴⁶ KPrP, Neni 25(2).

⁴⁷ Ligji Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë', Nenet 3(2); 6(3), etj.

⁴⁸ Ligji Nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', Neni 3(2).

⁴⁹ <https://www.magjistratura.edu.al/sq/programi-i-trajnimeve>

rregullimit të marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë, për të garantuar paanshmërinë dhe shmangien e çdo lloj influence ndaj prokurorit⁵⁰. Sipas të njëjtit raport, një fokus i veçantë i është kushtuar procesit të shortimit të dosjeve, duke patur në konsideratë një shpërndarje të drejtë jo vetëm në numër, por edhe në vepra penale, element ky, që sipas raportit është respektuar nga ana e drejtuesit të prokurorisë. Megjithatë, ende mbetet e papërcaktuar në detaje mënyra se si do të vlerësohet ngarkesa aktuale e prokurorëve dhe ngarkesa e secilës dosje të re, për të realizuar një shpërndarje sa më të balancuar. Ashtu si është diskutuar edhe në këtë raport, kategorizimi i çështjeve në bazë të një sistemi pikëzimi do të ishte një zgjidhje transparente dhe e balancuar e ndarjes së çështjeve sipas ngarkesës. Gjithsesi as Raporti Vjetor dhe as Plani i Veprimit nuk përmbajnë informacione lidhur me mundësinë e kategorizimit formal të çështjeve.

Rritja e cilësisë së përfaqësimit të organit të akuzës në veprat penale të dhunës në familje dhe ndaj të miturve

Plani i Veprimit ka vendosur një theks të veçantë tek: rritja e cilësisë së akteve dhe përfaqësimit në këto raste; ashpërsimi i masave të sigurimit personal dhe të masave të dënimit për këto vepra; rritja e pjesëmarrjes së prokurorëve në trajnime të formimit vazhdues me karakter kombëtar e ndërkombëtar lidhur me këto vepra; trajtimin me kujdes të veçantë të procesit të përpilimit të treguesve statistikorë lidhur me këto vepra; si dhe mbrojtjen e viktimave të këtyre veprave penale⁵¹. Po ashtu, Udhëzimi i Përgjithshëm i PP 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm' rekomandon përmirësimin e kushteve për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit⁵². Gjithashtu Udhëzimi i mësipërm inkurajon komunikimin dhe mbështetjen e viktimave të veprës penale të dhunës në familje dhe ndaj të miturve, si dhe të trajtuarit me kujdes të veçantë në përpilimin e treguesve statistikorë për identifikimin e viktimave të veprës penale të dhunës në familje dhe ndaj të miturve. Gjithashtu, ky Udhëzim kërkon ashpërsimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurimit personal dhe për caktimin e llojit dhe masës së dënimit për veprat penale në fushat e (ndër të tjera): krimit në familje, dhunës ndaj grave, si dhe rastet e keqtrajtimit, shryrëymit dhe trafikimit të fëmijëve.⁵³ Bazuar në Planin e Veprimit dhe Udhëzimit Nr. 05 datë 16.05.2024 të Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit ka nxjerrë aktin administrativ për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi, Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 01 datë 31.05.2024 'Për zbatimin e udhëzimit Nr. 05 datë 16.05.2024 të Prokurorit të Përgjithshëm nxjerrë mbi vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 243 datë 17.04.2024 'Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024'. Sipas Raportit Vjetor për ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit për vitin 2024, në këtë udhëzim janë përcaktuar masat

⁵⁰ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 35.

⁵¹ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 36.

⁵² Udhëzimi i Përgjithshëm i PP Nr. 5 datë 16.05.2024 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm', Neni 6(2)(ç).

⁵³ Udhëzimi i Përgjithshëm i PP Nr. 5 datë 16.05.2024 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm', Neni 8(1)(i).

administrative dhe procedurale për realizimin e përparësive.⁵⁴ Raporti i mësipër shprehet se, në zbatim të Planit të Veprimit dhe Udhëzimit të PP në drejtim të veprave të dhunës në familje dhe ndaj të miturve, kjo Prokurori ka respektuar nxitjen e dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqësore (përfshirë të miturit), si dhe është vijuar me ashpërsimin e masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe në rastet e keqtrajtimit/abuzimit, shfrytëzimit dhe trafikimit të fëmijëve.⁵⁵ Megjithatë, raporti në këtë rast nuk jep të dhëna lidhur me veprat penale të dhunës në familje në menyrë specifike.

Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) për arritjen e standardeve të unifikuara në zbatim të ligjit

Një nga shtyllat më kryesore të Planit të Veprimit në drejtim të përforcimit të standardeve të procesit të rregullt ligjor është angazhimi për forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me ILD-në për të arritur standarde të unifikuara në zbatimin e ligjit gjatë ushtrimit të funksionit, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal, si dhe për shkelje individuale të magjistratëve dhe respektimin e të drejtave të njeriut⁵⁶. Lidhur me këtë angazhim, Raporti i Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024 shprehet se prokurorët pranë kësaj prokurorie kanë treguar një vëmendje më të shtuar tek afatet e shuarjes së masave të sigurimit për shkak të mabrimit të dënimit, si dhe afatet e gjykimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.⁵⁷ Megjithatë, vetë raporti nuk jep statistika lidhur me përmirësimin e respektimit të afateve procedurale në raport me vitet e kaluara.

III.2.2 Standarde të tjera ndërkombëtare për të siguruar procesin e rregullt ligjor në përfaqësimin e akuzës nga Prokuroria e Apelit

Përveç prioriteteve të caktuara nga Plani i Veprimit për Prokurorinë e Apelit, kjo prokurori udhëhiqet edhe nga standarde të tjera ndërkombëtare që lidhen me respektimin e të drejtave substanciale dhe procedurale të njeriut. Ashtu sic është nënvizuar edhe në Raportin e Parë të Monitorimit për Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas ligjit Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë', prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi⁵⁸. *Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)* është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar, e cila është pjesë e kuadrit ligjor shqiptar. Sipas Nenit 17(2) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, limitimet ndaj të drejtave të njeriut nuk mund të tejkalojnë parashikimet e KEDNJ-së. Kjo dispozitë i rezervon një status të veçantë në hierarkinë e normave të së drejtës në Shqipëri kësaj Konvente. Neni 6

⁵⁴ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 38.

⁵⁵ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 39.

⁵⁶ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 37.

⁵⁷ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 37.

⁵⁸ Ligji Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë', Neni 4(1).

i KEDNJ, i cili parashikon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, përfshin të drejtën për një procedurë pa vonesa të paarsyeshme dhe të drejtë e në përmbajtje dhe meritë, si edhe pavarësi, paanësi dhe llovaridhënie në vendimmarrje.

Në këtë kuadër, trajnimi vazhdues i prokurorëve (si edhe gjyqtarëve) lidhur me ofrimin e njohurive të thelluara mbi jurisprudencën e GJEDNJ-së ka qenë një nga pikat kryesore të programit të trajnimit vazhdues, ashtu sic është nënvizuar edhe nga SND për vitet 2024-2030.⁵⁹ Në të njëjtën linjë, Kalendar i Trajnimit Vazhdues të Magjistratëve i publikuar nga Shkolla e Magjistraturës për vitin akademik 2025-2026 thekson faktin që në çdo temë do të bëhet kujdes që ekspertët të sjellin problematikën aktuale, si nga këndvështrimi i doktrinës e jurisprudencës shqiptare, ashtu edhe të GJEDNJ-së e GJED-së sipas rastit⁶⁰. Raporti i vlerësimit për veprimtarinë e vlerësimit të prokurorëve nga KLP në vitin 2024 ka evidentuar si mangësi në sistemin e prokurorisë në përgjithësi mungesën e analizës së jurisprudencës në disa vendime të hartuara nga prokurorët⁶¹, por ky vlerësim lidhet me sistemin e prokurorisë në përgjithësi, dhe jo në mënyrë të posaçme me Prokurorinë e Apelit.

Një nga qëllimet e ndryshimit të hartës gjyqësore dhe qendërimit të Prokurorisë së Apelit ishte pikërisht uniformiteti në zbatimin e parimeve dhe standardeve (ndër të tjera) të procesit të rregullt ligjor. Për këtë arsye, rëndësia e respektimit dhe zbatimit të saktë të standardeve më të mira ndërkombëtare, sidomos lidhur me procesin e rregullt ligjor, mbetet primare. Lidhur me këtë çështje, Raporti Vjetor i PA për vitin 2024 është shprehur se për shkak të krijimit të një gjykate në rang republike, ka rëndësi diskutimi i vazhdueshëm mes prokurorëve për të mundësuar qendrim të njëjta, për çështje të njëjta, për aq sa është e mundur pa cenuar pavarësinë e vendimmarrjes së prokurorit, me qëllim edhe një unifikim praktike⁶².

Në mënyrë që prokuroria të ketë mundësi të zbatojë standardet ndërkombëtare të procesit të rregullt ligjor, është e nevojshme t'i ofrohen kushte të mjaftueshme për të hulumtuar dhe studiuar lidhur me çështjen që i është caktuar. Raporti i PA për vitin 2024 konstaton se për shkak të numrit të konsiderueshëm të çështjeve dhe përparësisë që kanë çështjet me të pandehur me masa sigurimi 'arrest në burg', planifikimi i tyre prej gjyqtarëve bëhet jo në mënyrë periodike (praktika ka qenë që çështjet e themelit vireshin në dispozicion për t'u studiuar të paktën një muaj para fillimit të gjykimit) por sipas ngutshmërisë që ka çështja, duke patur një kohë relative në dispozicion për studimin e çështjes⁶³. Kjo është një praktikë që është e nevojshme të përmirësohet nga sistemi gjyqësor, në mënyrë që edhe niveli i arsyetimit ligjor të ndjekjes penale të jetë në përputhje jo vetëm me legjislacionin kombëtar, por edhe me standardet e parashikuara nga KEDNJ apo instrumenta ligjorë të BE-së.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut në përgjithësi

⁵⁹ Strategjia Ndërsektoriale për Drejtësinë 2024-2030, faqe 114.

⁶⁰ Kalendar i Trajnimit Vazhdues i Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2025-2026, <https://www.magjistratura.edu.al/sq/kalendar-i-trajnimeve>, faqe 1.

⁶¹ Raporti i vlerësimit për veprimtarinë e vlerësimit të prokurorëve nga KLP në vitin 2024, faqe 2.

⁶² Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 35.

⁶³ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 3.

Raporti i PA për vitin 2024 ka nënvizuar nevojën dhe rëndësinë për arritjen e standardeve të unifikuara në PA lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Sipas këtij raporti, prokurorët e PA kanë treguar një vëmendje të shtuar tek afatet e shuarjes së masave të sigurimit për shkak të mbarimit të dënimit, si dhe afatet e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm⁶⁴.

Gjithashtu, në drejtim të forcimit të respektimit të të drejtave të njeriut, Prokuroria e Apelit gjatë vitit 2024 ka inkurajuar aplikimin e dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore⁶⁵. Trajtimi i të miturve në procesin penal ka marrë ndër vite një vëmendje të veçantë, ashtu sic parashikohet edhe nga Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me mbrojtjen e viktimave, sidomos viktimave të mitura⁶⁶. Po ashtu, Udhëzimi i Përgjithshëm i PP 'Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm', i dedikon një hapësirë të rëndësishme garantimit të të drejtave dhe lirive të subjekteve të procedimit penal, sidomos marrjes së masave për zbatimin e procesit të rregullt ligjor për personat me masë sigurimi personal, personat nën hetim, të pandehurit dhe/ose viktimat e veprave penale⁶⁷. Raporti i Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024 dëshmon për ashpërsimin e masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat penale me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe në rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit/trafikimit të të miturve⁶⁸.

Referimet e mësipërme të Raportit Vjetor të Prokurorisë së Apelit për vitin 2024 lidhen me të drejtat e njeriut me përmbajtje substanciale, si të drejtat e të miturve, barazia gjinore, mbrojtja nga diskriminimi, etj. Megjithatë, ky raport nuk përmban të dhëna lidhur me mënyrën konkrete të garantimit të një grupi të drejtash të njeriut po aq të rëndësishme, dhe thelbësore në punën e Prokurorisë së Apelit, si disa të drejta procedurale (për shembull: informimi i personave nën hetim, informimi i publikut, transparenca në vendimmarrje, e drejta për të aksesuar dosjen), me përjashtim të arritjes së afateve procedurale, të cilat përmenden në raport. Kjo nuk do të thotë që këto të drejta nuk janë garantuar gjatë periudhës së këtij monitorimi, por nuk ka të dhëna të raportuara lidhur me to.

Parimi i procesit të rregullt ligjor

⁶⁴ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 37.

⁶⁵ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 39.

⁶⁶ Shiko, për shembull, Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 5/2018, Nr. 17/2020 dhe Nr. 8/2021.

⁶⁷ Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 01 datë 26.01.2023 'Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm', Neni 10.

⁶⁸ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 39.

Parimi i procesit të rregullt ligjor është një parim themeltar i një shteti demokratik, i parashikuar ndër të tjera nga KEDNJ në Nenin 6, dhe ka të bëjë kryesisht me garantimin e një procesi të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm, të pavarur dhe të paanshëm. Respektimi i procesit të rregullt ligjor lidhet me respektimin e shumë aspekteve të të drejtave procedurale, si e drejta për t'u dëgjuar, parimi i barazisë së armëve, e drejta për akses në informacion, transparenca e procesit, si dhe garantimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Ndërsa një pjesë e këtyre parimeve janë trajtuar në Raportin e Parë të Monitorimit të Prokurorisë së Apelit (mars 2025), në këtë Raport të Dytë elaborohen të tjera parime pjesë të garancive të procesit të rregullt ligjor, të cilat janë evidentuar në mënyrë të posaçme nga raportet që janë publikuar gjatë këtij gjashtëmujori. Përveç elementëve të procesit të rregullt ligjor të diskutuara nga Raporti i Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe të elaboruara në pjesën III.2.1 më lart, në objekt të kësaj analize, është me rëndësi të diskutohen edhe disa aspekte të tjera të procesit të rregullt ligjor, si më poshtë:

Llogaridhënia. Sistemi i prokurorisë është ndërtuar i tillë që parimi i llogaridhënies të aplikohet i plotë dhe të kalojë nëpër disa filtra. Së pari, puna e Prokurorisë së Apelit mbikëqyret nga Drejtuesi i Prokurorisë, i cili ka kompetenca: të mbikëqyrë disiplinën në punë të prokurorëve; t'i bëjë kërkesë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të prokurorëve⁶⁹; të mbikëqyrë organizimin dhe funksionimin e administratës së prokurorisë për veprimtaritë që nuk lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale, në rast se nuk është parashikuar ndryshe me ligj⁷⁰; si dhe të mbikëqyrë respektimin e etikës së prokurorit dhe planifikimin e punës së tyre, dhe angazhimet ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore⁷¹. Drejtuesi i prokurorisë informon çdo tre muaj Prokurorin e Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit, si dhe çdo vit i paraqet raportin vjetor të punës së prokurorisë. Kompetencat mbikëqyrëse të Prokurorisë së Përgjithshme përcaktohen në Ligjin 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë'⁷². Kompetencat mbikëqyrëse dhe verifikuese të PP detajohen më tej në Udhëzimin e Përgjithshëm të PP 'Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore', i cili përcakton se disa nga këto kompetenca janë: mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit ligjor të sistemit të drejtësisë penale nga prokurorët; zbatimi i urdhërave dhe udhëzimeve të përgjithshme të PP; sigurimi i përmbajtjes dhe saktësisë së të dhënave të raportit vjetor mbi ecurinë e punës në prokurori; etj.⁷³

Gjithashtu, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme raportojnë, të paktën një herë në vit, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së

⁶⁹ Ligji Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë', Neni 42(dh).

⁷⁰ Ligji Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë', Neni 42(f).

⁷¹ Ligji Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë', Neni 42(k).

⁷² Ligji Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë', Neni 38(f), (i).

⁷³ Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 10/2021 'Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore', Neni 5.

strukturave përkatëse⁷⁴. Raportimet vjetore lidhur me punën e Prokurorisë së Apelit janë realizuar periodikisht në përputhje me afatet e përcaktuara si nga ana e vetë kësaj prokurorie, ashtu edhe në vijim nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe nga KLP.

E drejta për një procedurë brenda afateve të parashikuara me ligj ka qenë një nga pikat ku Prokuroria e Apelit gjatë periudhës së monitorimit ka treguar një vëmendje të shtuar. Ashtu sic është diskutuar edhe në kapitullin e këtij raporti lidhur me efikasitetin në punën e kësaj prokurorie, Raporti i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për vitin 2024 shprehet se çështjet që dalin për shqyrtim janë të kushtëzuara nga masa e sigurimit, dhe nevoja për respektimin e të drejtave procedurale sidomos të personave nën arrest⁷⁵. Kjo është një zgjidhje racionale por vetëm momentale, pasi parimi i respektimit të procesit të rregullt ligjor (përfshirë këtu respektimin e afateve procedurale dhe procedimin pa vonesa) është një e drejtë themelore e njeriut, dhe si e tillë duhet të zbatohet në çdo rast, edhe në kushtet e një mase sigurimi që nuk përfshin arrestin me burg.

E drejta e publikut për informim dhe transparenca për Prokurorinë e Apelit janë një element i domosdoshëm për shtimin e besimit të publikut, llogaridhënies dhe përafrimit me standardet e BE-së. Sipas Raportit Vjetor të parafundit të kësaj prokurorie, gjatë vitit 2023 pranë Prokurorisë së Apelit u përcaktuan Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Prokurori i Medias.⁷⁶ Aktualisht, në faqen zyrtare të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit⁷⁷ shfaqet vetëm kontakti i Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ndërsa vazhdon të mos ketë të dhëna lidhur me emrin apo kontaktin e Prokurorit të Medias. Po ashtu, rubrika e dokumenteve nuk është e përditësuar; për shembull, deri në shtator 2025 nuk ka qenë i publikuar raporti vjetor i kësaj prokurorie për vitin 2024, pavarësisht se ai është përfunduar më herët. Po ashtu, pavarësisht parashikimit të ligjit 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë' i cili parashikon se 'udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesve të prokurorive publikohen në faqen e internetit të prokurorisë'⁷⁸, një pjesë e udhëzimeve të kësaj prokurorie, të miratuara në vitin 2024 sipas raportit të të njëjtit vit, nuk janë bërë ende publike në faqen zyrtare të kësaj prokurorie.

III.2.3 Konkluzione lidhur me standardet e veprimeve të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Raportet kombëtare të trajtuara në këtë Raport Monitorimi parashikojnë një sërë standardesh për të garantuar procesin e rregullt ligjor në përfaqësimin e akuzës nga Prokuroria e Apelit, duke përfshirë pavarësinë dhe paanësinë e prokurorëve, respektimin e etikës profesionale dhe mekanizmat e llogaridhënies. Kushtetuta, ligjet organike dhe udhëzimet e Prokurorisë së Përgjithshme konsolidojnë këto garanci, ndërsa Plani i Veprimit për vitin 2024 i kushton rëndësi forcimit të procedurave, përfaqësimit në çështjet e dhunës në familje dhe ndaj të miturve, si dhe bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për standarde të unifikuara

⁷⁴ Ligji Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë', Neni 105.

⁷⁵ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 40.

⁷⁶ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 36.

⁷⁷ https://www.pp.gov.al/Prokuroria_e_Apelit_Tirane/Media/, aksesuar në shkurt 2025.

⁷⁸ Ligji Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë', Neni 46(5).


në zbatimin e këtyre garancive. Përveç sa më sipër, Prokuroria e Apelit udhëhiqet nga një kuadër i gjerë ligjor dhe standarde ndërkombëtare që garantojnë respektimin e procesit të rregullt ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos Neni 6 i KEDNJ-së, garanton pavarësinë, paanësinë dhe llogaridhënien e prokurorëve. Raportet e viteve të fundit theksojnë përpjekjet për rritjen e cilësisë së përfaqësimit, sidomos në çështjet që lidhen me dhunën në familje dhe ndaj të miturve, si dhe aplikimin e dënimeve alternative për kategori vulnerabël. Megjithatë, mbeten ende sfida lidhur me garantimin e kushteve për një proces pa vonesa, përmirësimin e transparencës publike dhe publikimin në kohë të dokumenteve zyrtare.

III.3 Pranueshmëria e vendimeve/kërkesave të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

III.3.1 Pranueshmëria e vendimeve/kërkesave nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Analiza statistikore e nivelit të pranueshmërisë së kërkesave dhe vendimeve të Prokurorisë së Apelit nga Gjykata e Apelit përbën një mjet të domosdoshëm për vlerësimin e cilësisë së punës së kësaj prokurorie dhe drejtësisë penale në përgjithësi. Ky proces lejon të kuptohet nëse gjykatat ruajnë një ekuilibër të duhur midis rolit të prokurorisë dhe garancive që u ofrohen të pandehurve, duke evidentuar tendencat mbi prirjen për të konfirmuar, refuzuar apo modifikuar kërkesat e organit të akuzës. Përmes këtyre statistikave sigurohet transparencë dhe llogaridhënie institucionale, duke mundësuar monitorimin e praktikave vendimmarrëse dhe identifikimin e rasteve kur mund të ketë shmangie nga standardet e procesit të rregullt ligjor.


Sipas Raportit të vitit 2024, PA i është drejtuar Gjykatës së Apelit me 127 kërkesa për *ndryshim të vendimit të Shkallës së Parë me rëndim të pozitës së të pandehurit*, nga të cilat 65 janë pranuar nga gjykata, pra rreth 51,2% e kërkesave⁷⁹.



⁷⁹ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 10.


Burimi i të dhënave: Raporti vjetor i PA për vitin 2024

Niveli i pranueshmërisë së kërkesave të PA gjatë vitit 2024 ka qenë më i lartë lidhur me kërkesat e PA për lehtësim të pozitës së të pandehurit, ku nga 88 kërkesa të tilla, GJA ka pranuar 80 prej tyre, pra rreth 90,9% të kërkesave.⁸⁰



Burimi i të dhënave: Raporti vjetor i PA për vitin 2024

Gjithashtu gjatë këtij viti, për 787 kërkesat e PA për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit ka pranuar këtë kërkesë për 505 prej tyre, pra në 64,2% të rasteve.⁸¹



⁸⁰ Ibid.

⁸¹ Ibid.

Burimi i të dhënave: Raporti vjetor i PA për vitin 2024

Nga të dhënat e mësipërme, shihet se niveli i pranueshmërisë së kërkesave të Prokurorisë së Apelit nga Gjykata e Apelit është përgjithësisht i lartë, edhe pse ndryshon sipas llojit të kërkesës. Ky është një tregues pozitiv për punën e qendrueshme të PA. Në rastet për rëndimin e pozitës së të pandehurit, pranimet dhe refuzimet janë pothuajse të balancuara, çka tregon kujdes dhe selektivitet nga ana e GJA. Ndërsa për lehtësimin e pozitës së të pandehurit, gjykata ka pranuar shumicën dërrmuese të kërkesave, duke reflektuar një qasje më të favorshme ndaj rrethanave lehtësuese. Për kërkesat për lëniën në fuqi të vendimeve të Shkallës së Parë, shumica dërrmuese janë pranuar, duke treguar një prirje të fortë të gjykatës për të konfirmuar vendimet e shkallës së parë dhe për të ruajtur stabilitetin juridik. Prandaj, në tërësi mund të vlerësohet se gjykata shfaq një nivel të lartë pranueshmërie ndaj kërkesave të prokurorisë, me dallime të qarta në varësi të natyrës së tyre.

III.3.2 Pranueshmëria e vendimeve/kërkesave nga Gjykata e Lartë

Përsa i përket rekurseve të Prokurorisë së Apelit kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit (në rastet kur këto të fundit kanë qenë të ndryshme nga kërkimet e akuzës), raporti i kësaj prokurorie për vitin 2024 shprehet se një pjesë e konsiderueshme e rekurseve të përpiluara nga ana e prokurorëve të apelit janë gjetur të drejta nga ana e GJL, duke passjellë një unifikim praktike vendimmarrëse të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm⁸². Ky raport, ashtu si edhe raporti i vitit paraardhës, nuk jep të dhëna apo shifra konkrete lidhur me nivelin e pranueshmërisë së rekurseve të nisura nga ana e Prokurorisë së Apelit, duke krijuar paqartësi lidhur me qendrueshmërinë e vendimeve apo kërkesave të kësaj prokurorie në GJL.

III.3.3 Konkluzione lidhur me pranueshmërinë e vendimeve/kërkesave të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Gjatë vitit 2024, kërkesat e Prokurorisë së Apelit drejtuar Gjykatës së Apelit kanë qenë të ndryshme, duke përfshirë kërkesa për rëndim të pozitës së të pandehurit, kërkesa për lehtësim të pozitës së të pandehurit, dhe kërkesa për lëniën në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Nga të dhënat statistikore të përpunuara dhe analizuara më sipër, mund të konkludohet se niveli i pranueshmërisë së kërkesave të Prokurorisë së Apelit nga Gjykata e Apelit është përgjithësisht i lartë, edhe pse ndryshon sipas llojit të kërkesës. Ky është një tregues pozitiv për punën e qendrueshme të Prokurorisë së Apelit. Nga ana tjetër, Raportet e dy viteve të fundit të kësaj prokurorie nuk ofrojnë të dhëna konkrete lidhur me nivelin e pranueshmërisë së vendimeve të kësaj prokurorie në Gjykatën e Lartë.

III.4 Zhvillimi profesional i prokurorëve

III.4.1 Trajnimet vazhduese dhe sfidat e zhvillimit profesional shumëdimensional të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit

Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues është një detyrim që rrjedh nga Ligji Nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', sipas të cilit

⁸² Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 40.

magjistratët (në kontekst të këtij Raporti, prokurorët), kanë të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me KLP-në, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit⁸³. Ashtu sic është diskutuar në Raportin e Parë të Monitorimit për Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (mars 2025), Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe, sipas rastit, me Avokaturën e Shtetit harton dhe organizon Programin e Formimit Vazhdues për (ndër të tjerë) prokurorët. Aktualisht, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka publikuar programin e formimit vazhdues për vitin akademik 2025-2026, ku ka detajuar fushat e trajnimeve dhe temat përkatëse për secilën fushë⁸⁴. Një aspekt pozitiv që bie në sy së fundmi është fakti që temat e trajnimit përfshijnë elementë jo vetëm të së drejtës substanciale, asaj procedurale, por edhe elementë të mirëmenaxhimit të burimeve ndihmëse, burimeve njerëzore dhe teknologjisë; çështje të etikës dhe komunikimit; përpunimi i të dhënave statistikore për njohjen e veprimtarisë së prokurorisë; intelijenca artificiale dhe etika; etj. Gjithashtu, një pjesë e trajnimeve janë për prokurorë që mbajnë detyra shtesë administrative, si drejtuesi i prokurorisë, prokurori i medias, etj. Në përputhje edhe me parashikimet e Planit të Veprimit për Vitin 2024, Prokuroria e Apelit është e nevojshme t'i kushtojë një rëndësi të veçantë trajnimit vazhdues të prokurorëve sidomos në fushën e veprave penale të dhunës në familje dhe atyre ndaj të miturve⁸⁵.

Lidhur me programin e trajnimit, referuar edhe praktikave më të mira të shteteve të tjera, trajnimi i prokurorëve duhet të paraprihet nga një **vlerësim paraprak i nevojave individuale për trajnim** nga njësia përgjegjëse (në këtë rast, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit). Në këtë mënyrë, trajnimi i secilit prokuror ka potencialin të jetë më efektiv dhe planifikimi i trajnimeve realizohet mbi baza nevojash aktuale⁸⁶.

III.4.2 Trajnimet për punonjësit e administratës pranë Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Përveç formimit vazhdues profesional të prokurorëve, është e nevojshme që t'i nënshtrohet formateve të zhvillimit profesional edhe personeli administrativ i Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, përtej trajnimit fillestar nga ASPA gjatë periudhës së punës në provë.⁸⁷ Aktualisht rezulton se numri i këtij personeli është pak a shumë i njëjtë me numrin para se të miratohej ndryshimi i hartës së re gjyqësore.

Në këto kushte, stafi administrativ i kësaj prokurorie, ashtu si edhe prokurorët, është vendosur para një fluksi shumë më të madh dosjesh dhe pune. Përtej nevojës për shtimin e kapacitetit administrativ të kësaj prokurorie, është gjithashtu e nevojshme që punonjësit ekzistues të administratës të kalojnë nëpër seanca trajnimesh dhe klasash formimi profesional për menaxhimin sa më efektiv të ngarkesës dhe metodat më eficiente të shpejtësisë dhe cilësisë në

⁸³ Neni 5 i Ligjit Nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'.

⁸⁴ Për më shumë informacion, vizito Kalendarin e Trajnimeve në faqen e internetit të Shkollës së Magjistraturës: <https://www.magjistratura.edu.al/sq/kalendari-i-trajnimeve>

⁸⁵ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, faqe 36.

⁸⁶ Shiko, për shembull: OECD, Performance of the Prosecution Services in Latvia, a comparative study, 2021, faqe 103.

⁸⁷ Shiko, për shembull: Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2024, faqe 215.

punë. Raporti vjetor i Prokurorisë së Apelit nuk shprehet lidhur ofrimin e mundësisë së këtyre trajnimeve.

III.4.3 Konkluzione lidhur me zhvillimin profesional të prokurorëve dhe administratës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Trajnimi vazhdues i prokurorëve të Prokurorisë së Apelit mbetet një komponent thelbësor për garantimin e zhvillimit profesional dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të prokurorisë. Programi i formimit për vitin akademik i Shkollës së Magjistraturës për vitin 2025-2026 përfshin jo vetëm çështje substanciale dhe procedurale, por edhe tema të lidhura me etikën, komunikimin, përdorimin e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore e statistikave, çka është tregues për rëndësinë që aspektet e mirëmenaxhimit të çështjeve kanë marrë së fundmi. Përveç sa më sipër, programi i trajnimit duhet të pasurohet edhe nga një vlerësim paraprak i nevojave konkrete të çdo prokurori, në mënyrë që programi të orientohe mbi sfida aktuale. Krahas kësaj, edhe personeli administrativ përballet me një ngarkesë të shtuar për shkak të ndryshimeve në hartën gjyqësore, çka nënvizon domosdoshmërinë e ofrimit të trajnimeve profesionale për rritjen e aftësive në menaxhimin e punës dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve. Për këtë arsye, trajnimi i vazhdueshëm i të dyja kategorive, prokurorëve dhe stafit administrativ, mbetet një parakusht i domosdoshëm për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e punës së Prokurorisë së Apelit.

IV. Konkluzione Përfundimtare dhe Rekomandime

Ky Raport i Dytë Monitorimi për veprimtarinë e Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm u përqendrua tek zhvillimet kryesore të gjashtëmujorit të fundit (mars 2025-shtator 2025) lidhur me këtë prokurori, si edhe mënyrën e zbatimit të garancive që lidhen me respektimin e procesit të rregullt ligjor. Ashtu si edhe Raporti i Parë i Monitorimit, ky raport detajoi elementet përbërëse të efikasitetit dhe cilësisë së punës së kësaj prokurorie, nën dritën e zhvillimeve të reja, duke sugjeruar dhe zgjidhje të mundshme për problematikat e evidentuara.

Lidhur me **efikasitetin** e punës së kësaj prokurorie, ky Raport i Dytë Monitorimi arriti në këto përfundime kryesore:

Një tregues pozitiv për vitin 2024 është fakti që janë shënuar përmirësime në *respektimin e afateve ligjore*, duke reflektuar disiplinë institucionale më të konsoliduar. Në këtë kuadër, është me rëndësi të theksohet se gjatë vitit të fundit të raportuar nuk është regjistruar asnjë procedim disiplinor ndaj prokurorëve apo punonjësve të Prokurorisë së Apelit për shkelje të afateve ligjore, çka tregon një rritje të përgjegjshmërisë dhe respektimit të standardeve procedurale. Megjithatë, numri i reduktuar i prokurorëve në këtë prokurori e bën të pashmangshme mundësinë e shtyrjes së seancave gjyqësore për shkak të përplasjes së orareve me seanca të tjera që ndjek i njëjti prokuror.

Si masa efikase në reduktimin e kohëzgjatjes së çështjeve, ky raport ka propozuar rritjen e iniciativave për zbatimin e dënimeve alternative (në rastet kur diçka e tillë është e parashikuar në ligj), me qëllim reduktimin e kohëzgjatjes dhe kostos së procedurave; si dhe përdorimin e një numri unik të çështjes, i pandryshuar në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor, çka do të shmangte vonesa burokratike apo gabime njerëzore.

Raporti vjetor i Prokurorisë së Apelit për vitin 2024 tregoi se ritmi i shqyrtimit të çështjeve ka qenë i kushtëzuar kryesisht nga masat e sigurimit personal dhe *domosdoshmëria e respektimit të të drejtave procedurale të personave nën hetim, veçanërisht atyre që ndodhen në arrest*. Në praktikë, çështjet që lidhen me masën e sigurimit 'arrest në burg' kanë marrë përparësi, qasje që shërben si zgjidhje pragmatike për situata urgjente, por që nuk mund të mbetet e vetmja mënyrë funksionimi. Respektimi i parimit të procesit të rregullt ligjor, i cili përfshin zhvillimin e procedimeve pa vonesa dhe garantimin e afateve procedurale, është një e drejtë themelore e njeriut dhe duhet të zbatohet në çdo rast, pavarësisht llojit të masës së sigurimit.

Gjatë gjashtëmujorit të fundit nuk ka patur ndryshime lidhur me mënyrën e *kategorizimit të çështjeve* brenda Prokurorisë së Apelit. Kjo e fundit realizohet nga Drejtuesi i Prokurorisë, duke marrë parasysh kritere si: numri i çështjeve për prokuror; shkallës së rrezikshmërisë dhe rëndësisë së çështjes, si dhe nëse çështja gjykohet në apel mbi bazën e ankimeve të prokurorëve apo ankimeve të bëra nga ana e palëve të tjera në procesin penal. Megjithatë, nuk ka ende një rregullore lidhur me metodën e kategorizimit të çështjeve, për të unifikuar këtë praktikë nëpërmjet një metode me efikase si 'case weighting', e cila përdor sistemin e indekseve dhe pikëzimit, për të arritur një rezultat sa më uniform të shpërndarjes së çështjeve mes prokurorëve.

Pavarësisht rritjes së ndjeshme prej rreth 15.7% të çështjeve të trajtuara në total (masa siguri dhe çështje themeli), *kjo rritje nuk është reflektuar në reduktimin e vakancave* të numrit të prokurorëve në këtë prokurori, duke shkaktuar një mbingarjesë të ndjeshme tek prokurorët, me 391 çështje për prokuror në vit, në krahasim me mesataren prej 215 të tillash në vit. Një rritje kaq e ndjeshme ka potencialin të ndikojë negativisht në efikasitetin dhe cilësinë e punës së prokurorëve të apelit. I njëjti shqetësim vihet re edhe për punonjësit e administratës së prokurorisë.

Ende mungon sistemi digjital i menaxhimit të çështjeve në Prokurorinë e Apelit. Megjithatë, një zhvillim me rëndësi është krijimi i *databazës elektronike për burimet njerëzore* nga KLP, i cili përfaqëson një instrument strategjik për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin e prokurorisë, përfshirë Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ky mekanizëm siguron centralizimin dhe përditësimin në kohë reale të të dhënave mbi përbërjen, lëvizjet dhe karrierën e prokurorëve, duke rritur transparencën dhe objektivitetin në proceset e emërimit, transferimit dhe ngritjes në detyrë. Për të shfrytëzuar plotësisht potencialin e kësaj databaze, është e nevojshme që databaza të përdoret jo vetëm si një mjet teknik i menaxhimit administrativ, por edhe si instrument analitik për hartimin e politikave strategjike të burimeve njerëzore dhe për balancimin e ngarkesës së punës ndërmjet prokurorëve. Në këtë mënyrë, ajo do të kontribuojë drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit dhe në konsolidimin e transparencës dhe besueshmërisë së sistemit në sytë e publikut. Po ashtu, një zhvillim pozitiv në drejtim të menaxhimit digjital të çështjeve është zbatimi i projektit EU4Digital Justice “Mbështetje për Sundimin e Ligjit përmes Transformimit Digjital” që do të prezantojë një sistem modern dhe të unifikuar të menaxhimit të çështjeve për prokurorinë.

Lidhur me aspektin e **cilësisë** së punës së Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ky Raport i Dytë Monitorimi arriti në disa përfundime:

Një përditësim pozitiv lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve ka qenë vendimi i KLP-së për të *reduktuar detyrimin e plotësisht të disa rubrikave të të dhënave administrative nga prokuroritë* (si datat e dorëzimit të materialeve, afatet ligjore, mesataret dhe

rendimenti), me qëllim shkurtimin e kohës së përpunimit të statistikave. Ky ndryshim ka potencialin të përmirësojë ndjeshëm efikasitetin në vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve, duke lehtësuar procesin e mbledhjes së të dhënave dhe duke eliminuar ngërçet që në të kaluarën e kanë zgjatur në mënyrë të panevojshme këtë procedurë. Një sistem më i shpejtë dhe i saktë i raportimit administrativ pritet të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies së brendshme.

Në lidhje me zbatimin e garancive që lidhen me *procesin e rregullt ligjor*, vihet re nevoja që sistemi gjyqësor të vendosë çështjet e themelit në dispozicion të Prokurorisë së Apelit përpara fillimit të gjyqimit (preferueshmërisht një muaj para). Një afat i tillë do të siguronte jo vetëm përgatitjen e duhur procedurale, por edhe nivelin e duhur të arsytimit ligjor nga ana e ndjekjes penale. Në këtë mënyrë, praktikat gjyqësore do të ishin në përputhje të plotë jo vetëm me legjislacionin kombëtar, por edhe me standardet e përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe instrumentet ligjore të BE-së. Në drejtim të zbatimit të garancive të procesit të rregullt ligjor, është e nevojshme që t'i kushtohet një rëndësi e veçantë në raportimet vjetore të Prokurorisë së Apelit hapësirës së garantimit të të drejtave të njeriut, sidomos të drejtave procedurale, duke qenë se raportet aktuale në rubrikën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut fokusohen tek të drejtat substanciale. Sa i përket *transparencës institucionale* si element përbërës i procesit të rregullt, është e nevojshme të merren masa për publikimin në kohë më të shpejtë të raporteve vjetore dhe udhëzimeve të miratuara së fundmi.

Lidhur me *plotësimin dhe specializimin e burimeve njerëzore* në këtë prokurori, përveç nevojës për shtimin e numrit të prokurorëve të apelit, po aq i rëndësishëm është ndërtimi i një programi trajnimi vazhdues që të ndikojë maksimalisht në përmirësimin e cilësisë së punës në prokurori, të bazuar në nevoja praktike dhe aktuale të secilit prokuror. Përtej nevojës për shtimin e kapaciteteve administrative të kësaj prokurorie, është po aq e rëndësishme që punonjësit ekzistues të administratës të përfshihen në programe trajnimi dhe formimi profesional të vazhdueshëm. Këto trajnime duhet të fokusohen tek menaxhimi më efikas i ngarkesës së punës, përdorimi i metodave moderne për përshpejtimin e proceseve dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Burimet

Ligje dhe akte normative me fuqi nënligjore

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë
- Ligji Nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'
- Ligji 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë'
- Rregullorja e KLP Nr. 95 datë 09.05.2022 'Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve'
- Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për Raportin Vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për Vitin 2023"
- Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 5/2018

- Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 17/2020
- Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 8/2021
- Udhëzimi i PP Nr. 10, datë 30.12.2021 'Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore'
- Udhëzim i Përgjithshëm i PP Nr. 01 datë 26.01.2023 'Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm'
- Udhëzimi i Përgjithshëm i PP 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përdjithshëm'

Dokumente politikash dhe raportime nga organet relevante

- Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi të Drejtat e Njeriut për vitin 2024
- Raporti i 'Rule of Law' i Komisionit European për Shqipërinë, (2025)
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030 dhe Draft Raporti i Monitorimit janar-dhjetor 2024, https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2025/06/SND-Raport_Janar-Dhjetor-2024-final.pdf
- Raporti Vjetor pwr veprimtarinw e KLP pwr vitin 2024
- Raporti i vlerësimit për veprimtarinë e vlerësimit të prokurorëve nga KLP në vitin 2024
- Raporti Vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme 'Mbi ngarkesën e punës së prokurorive' (2024)
- Raporti Vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme 'Mbi ngarkesën e punës së prokurorive' (2024)
- Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2024
- Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (2023)
- Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (2024)

Artikuj dhe manuale

- Council of Europe, CEPEJ, Case weighting in European Justice Systems, 2018, https://rm.coe.int/cepej-saturn-2017-7erev10e-case-weighting/16808ccb22#_Toc510802389
- OECD, Performance of the Prosecution Services in Latvia, a comparative study, 2021,

Faqe interneti

- EU4 Digital Justice: EU and UNOPS Partnership to Strengthen Albania's Justice System, Qershor 2025, <https://www.unops.org/neës-and-stories/neës/eu4digital-justice-eu-and-unops-partnership-to-strengthen-albanias-justice-system>.
- Kalendar i Trajnimit Vazhdues i Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2025-2026, <https://www.magjistratura.edu.al/sq/kalendar-i-trajnimeve>, faqe 1.